



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO**  
**GJYKATA KOMERCIALE**

---

Numri i lëndës: 2024:047567  
Datë: 06.06.2024  
Numri i dokumentit: 05787900

KPPP.nr. 296/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Arbër Rexha, në çështjen përmbarimore të kreditorit NLB “Kasabank” Sh.A., me seli në Prishtinë, rr. “Rexhep Luci”, nr. 5, kundër debitorëve N.P.T. “Titi-Transport”, me seli në Malishevë, rr. “Imer Krasniqi”, p.nr.; dhe N.T.P “Sopaj”, me seli në Malishevë, rr. “Iliria”, p.nr., duke vendosur sipas kundërshtimit me kërkesë për kthim në gjendje të mëparshme të paraqitur nga debitorit “Titi-Transport”, ndaj Konkluzionit P.nr. 106/20, të datës 12.06.2020, të Përmbaruesit Privat Saranda Kuçi, jashtë seancës me datë 06.06.2024, merr këtë:

**A K T V E N D I M**

HEDHET poshtë kundërshtimi me kërkesë për kthim në gjendje të mëparshme i paraqitur me datë 29.07.2020, nga avokati Isa Salih i në emër të debitorit “Titi-Transport”, ndaj Konkluzionit të Përmbaruesit Privat Saranda Kuçi, P.nr. 106/20, të datës 12.06.2020, si i palejuar.

**A r s y e t i m**

Përmbaruesi Privat Saranda Kuçi, me datë 12.06.2020, ka nxjerr Konkluzionin P.nr. 106/2020, me të cilin janë njoftuar debitorët N.P.T. “Titit Transport” me seli në Malishevë dhe N.T.P. “Sopa”, me seli në Malishevë, se procedura e përmbarimit me shenjën E.nr. 245/2007, e iniciuar nga Kreditorit NLB Kasabank Sh.A., me seli në Prishtinë, në përputhje me nenin 397, paragrafi 2, 3, 4 dhe 5 të LPP-së, me kërkesën e kreditorit, është bartur nga Gjykata pranë Përmbaruesit Privat dhe se lënda ka marr numrin P.nr. 106/20. Ndërsa, në pikën II të dispozitivit të Konkluzionit është vendosur që të gjitha veprimet e procedurës përmbarimore që i ka ndërmarr

Gjykata Themelore në Gjakovë, Dega Malishevë, janë të vlefshme dhe procedura përmbarimore vazhdohet nga Përmbaruesi Privat sipas dispozitave të LPP-së.

Me datë 29.07.2020, avokati Isa Salihi në emër dhe për llogari të debitorit “Titi Transport”, ka paraqitur kundërshtim me kërkesë për kthim në gjendje të mëparshme ndaj Konkluzionit të Përmbaruesit Privat Saranda Kuçi, P.nr. 106/2020, të datës 12.06.2020, duke i propozuar gjykatës që ta anuloj konkluzionin në fjalë dhe të lejohet kthimi në gjendje të mëparshme si para datës 12.06.2020.

Gjykata, pas shqyrtimit paraprak të parashtresës ka gjetur se avokatit i mungon autorizimi për paraqitjen e kundërshtimit dhe kërkesës për kthim në gjendje të mëparshme në këtë çështje përmbarimore, andaj përmes Konkluzioni KPPP.nr. 296/22, të datës 04.04.2024, ka obliguar avokatin Isa Salihi që në afat prej 3 (tre) ditësh, nga dita e pranimit të këtij konkluzioni, Gjykatës t’ia sjellë autorizimin origjinal të nënshkruar dhe të vulosur nga Debitori N.P.T. “Titi-Transport” me të cilin vërtetohet se Debitori e ka autorizuar avokatin Isa Salihi për paraqitjen e kundërshtimit me kërkesë për kthim në gjendje të mëparshme ndaj Konkluzionit të Përmbaruesit Privat Saranda Kuçi, P.nr. 106/20, të datës 12.06.2020. Ndërsa, me të njëjtin konkluzion ka paralajmëruar edhe për pasojat se në rast se nuk veprohet brenda afatit të përcaktuar, gjykata do ta hedhë poshtë si të palejueshëm kundërshtimin me kërkesë për kthim në gjendje të mëparshme të paraqitur ndaj Konkluzionit të Përmbaruesit Privat Saranda Kuçi, P.nr. 106/20, të datës 12.06.2020.

Nga shkresat e lëndës, rezulton se avokati Isa Salihi Konkluzionin e kësaj gjykate KPPP.nr. 296/22, të datës 04.04.2022 e ka pranuar me datë 26.04.2024, ndërsa deri më datën e stome nuk ka vepruar sipas këtij konkluzioni, përkatësisht nuk ka paraqitur autorizimin e dhënë nga debitori për paraqitjen e kundërshtimit me kërkesë për kthim në gjendje të mëparshme dhe përfaqësim në këtë çështje përmbarimore.

Andaj, duke qenë se personi i cili ka paraqitur kundërshtimin dhe kërkesën për kthim në gjendje të mëparshme, përkatësisht avokati Isa Salihi nuk ka vepruar konform konkluzionit dhe nuk ka paraqitur autorizimin e dhënë nga debitori për përfaqësim në këtë çështje, gjykata në mbështetje të nenit 17 të LPP-së, ka aplikuar përshtatshmërisht dispozitat nga neni 179.2 të LPK-së i cili përcakton se *“Po që se ankuesi brenda afatit nga paragrafi 1 i këtij neni nuk vepron sipas kërkesës së gjykatës, gjykata me aktvendim e hedhë poshtë ankesën si jo të plotë”*, dhe në kuptim të nenit 73.3 të LPP-së me të cilin përcaktohet se *“Me vendim prapësimi mund të pranohet,*

*refuzohet ose hidhet poshtë si i pa afatshëm, si jo komplet dhe i palejuar*”, vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, duke hedhur kundërshtimin me kërkesë për kthim në gjendje të mëparshme si jo të plotë.

Nga sa më sipër, në mbështetje të nenit 73 të LPP-së, si dhe nenit 13, paragrafi 1, pika 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 296/22, datë 06.06.2024

Gjyqtari  
Arbër Rexha

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.